

UDHËZIM
Nr. 16, datë 5.7.2017

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 36, “Zbatimi i shkallës së TVSH-së”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind”.

2. Modeli i deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar, i përcaktuar në nenin 67 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar sipas këtij udhëzimi.

3. Modeli i librit të shitjeve, i përcaktuar në nenin 68 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e librit të shitjeve sipas këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Helga Vukaj



DEKLARATA E TATIMIT MBI VLEREN E SHITUAR

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per pendorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3) _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4) _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5) _____
Adresa: (6) _____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: (7) _____

Informacioni i mësipërm (rubrikat 4,5,6,7) duhet të jetë i saktë dhe i azhurnuar



[8] Shënoni 'X' nqs gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

- TVSH e llogaritur për muajin**
- (9) Shitje të përjashtuara
- (10) Shitje pa TVSH
- (11) Eksporte mallrash
- (12) Furnizime me shkallë 0%
- (13) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)
- (15) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)
- (17) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të ndihetimit/ të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%)
- (19) Antongarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge) (19 x 20%)
- (21) Borxhi i keq
- (23) Totali TVSH-së së llogaritur {(14)+(16)+(18)+(20)+(22)}

Vlera e tatueshme	TVSH e llogaritur
(9)	
(10)	
(11)	
(12)	
(13)	(14)
(15)	(16)
(17)	(18)
(19)	(20)
(21)	(22)
	(23)

- TVSH e zbritshme për muajin**
- (24) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH
- (25) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH
- (26) Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH
- (27) Import mallra të përjashtuara nga TVSH
- (28) Import mallra me shkallë tatimore 20%
- (30) Importe të investimit me TVSH 20%
- (32) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 20%
- (34) Blerje të Investimit brenda vendit me TVSH 20%
- (36) Blerje nga fermerët vendas (20%)
- (38) Antongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)
- (40) Rregullime të TVSH-së së zbritshme
- (42) Borxhi i keq
- (44) Totali TVSH-së së zbritshme {(29)+(31)+(33)+(35)+(37)+(39)+(41)+(43)}

Vlera e tatueshme	TVSH e zbritshme
(24)	
(25)	
(26)	
(27)	
(28)	(29)
(30)	(31)
(32)	(33)
(34)	(35)
(36)	(37)
(38)	(39)
(40)	(41)
(42)	(43)
	(44)

- (45) Teprica e TVSH se zbritshme për muajin {(23)-(44)}nqs{(23)<(44)}
- (46) TVSH I DETYRUESHEM PER TU PAGUAR {(23)-(44)}nqs{(23)>(44)}

	(45)
	(46)

Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësi time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.